




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/41 datë: 31.01.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), si dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në mbështetje të nenit 10.2 të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009; Të nxitur nga nevoja për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” si dhe çmimin “Qytetarë Nderi” për personalitetet që kanë dhënë kontribut domethënës për Komunën e Shtimes, duke respektuar procedurat e akteve ligjore dhe nënligjore, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 31.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E QELËSIT PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONEVE PËR
NDARJEN E ÇMIMEVE “NDERI I QYTETIT” DHE “QYTETARË NDERI”**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.01.2024, me shumicën e votave miratoi, strukturën (Qelësin) e përbërjes të Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” dhe çmimin “Qytetarë Nderi” në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Nga dy (2) anëtarë të Komisionit zgjidhen nga Kuvendi (1-Pozita dhe 1-Opozita),
2. Nga dy (2) anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi i Komunës të emëruar nga Kryetari i Komunës – Shtime.
3. Nga një (1) anëtar i Komisionit dërgohet nga Shoqëria Civile (OJQ) Komuna e Shtimes.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi